

**VENDIM**  
**Nr. 111/2024**

**PËR MIRATIMIN E ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE**  
**TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË PAS MBARIMIT TË MANDATIT**  
**TË KOMISIONERËVE PUBLIKË**

Në mbështetje të neneve 78, 179/b, pika 8, të Kushtetutës, neneve 18, pika 1, 70, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neneve 18 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionerëve Publikë,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Miratimin e organikës dhe klasifikimin e pagave të punonjësve administrativë pas mbarimit të mandatit të Komisionerëve Publikë, sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2025 deri në datën 30.6.2025.

**KRYETARE**  
**Elisa Spiropali**

Miraturar në datën 12.12.2024.

Lidhja nr. 1

**ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË**  
**PAS MBARIMIT TË MANDATIT TË KOMISIONERËVE PUBLIKË**

| <b>FUNKSIONI ORGANIK</b>                          | <b>Klasifikimi i pagës</b> | <b>Numri</b> |
|---------------------------------------------------|----------------------------|--------------|
| <b>I. KANCELAR</b>                                | <b>I-1</b>                 | <b>(1)</b>   |
| <b>II. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE</b>    |                            |              |
| <b>DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN</b>   |                            | <b>(7)</b>   |
| Drejtor                                           | I -4                       | 1            |
| Specialist sekretarie                             | IV-1                       | 2            |
| Specialist redaktor gjuhësor                      | IV-1                       | 1            |
| Përkthyes                                         | II -1                      | 1            |
| Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë | II -1                      | 1            |
| Specialist pritje me popullin                     | IV-1                       | 1            |
| <b>III. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE</b>  |                            | <b>(7)</b>   |
| <b>MBËSHTETËSE</b>                                |                            |              |
| Drejtor                                           | I-4                        | 1            |
| Specialist i burimeve njerëzore                   | IV-1                       | 1            |
| Specialist IT*                                    | IV-1                       | 1            |
| Specialist protokolli/arkivi**                    | IV-1                       | 1            |
| Magaznier                                         | VI                         | 1            |
| Punonjës pastrimi                                 | II                         | 1            |
| Shofer/korrier                                    | V                          | 1            |
| <b>Total</b>                                      |                            | <b>15</b>    |

*Shënim:*

\* Punonjësit në pozicionin e specialistëve të Teknologjisë së Informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

\*\* Punonjësit në pozicionet Specialist Arkivi përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

*\*\*\* Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve.*

*\*\*\*\* Punonjësit administrativë përfitojnë shtesën mujore për natyrë të veçantë pune në masën 10% të pagës për pozicion, apo të pagës bazë për klasë. Punonjësit administrativë, të cilët sipas këtij vendimi përfitojnë shtesa të tjera të së njëjtës natyre të përcaktuara në të, do të përfitojnë vetëm njërën prej shtesave, atë me vlerën më të madhe.*